

MINISTRIA E DIASPORËS / MINISTRY OF DIASPORA / MINISTARSTVO ZA DIJASPORU	
Nr. Org. Org. Jedin. Org. Unit	01
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	246
Nr. I faqes Broj stranica No. pages	02
Data. Datum: Date:	25.09.12
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës

*Qeveria*

*Ministria e Diasporës*



Instituti Albanologjik i Kosovës

## MEMORANDUM MIRËKUPTIMI PËR BASHKËPUNIM

Ndërmjet Ministrisë së Diasporës së Republikës së Kosovës dhe Institutit Albanologjik të Prishtinës

Ministria e Diasporës dhe Instituti Albanologjik i Prishtinës (më poshtë të quajtura “Palët”):

Të udhëhequr nga parimet e mirëkuptimit dhe të qëllimeve që janë në interes të vendit dhe të popullit tonë, veçmas ngritjes së cilësisë së studimeve lidhur me diasporën shqiptare në botë, në radhë të parë të pjesëtarët e mërgatës së Kosovës, pajtohen të nënshkruajnë këtë Memorandum Mirëkuptimi.

### Objektivat:

Palët zotohen që, nëpërmjet realizimit të projekteve konkrete, të punojnë në mënyrë të vazhdueshme për përmbushjen e këtyre objektivave:

1. Vlerësimin shkencor të gjendjes aktuale në pikëpamje të identitetit kombëtar e social të diasporës shqiptare të Kosovës;
2. Ruajtjen dhe kultivimin e vlerave esenciale identitare të diasporës së shqiptarëve të Kosovës;
3. Prezantimin e identitetit kombëtar shqiptar në botë;
4. Studimin e ndikimit të kulturave pritëse në jetën shoqërore e kulturore të diasporës së shqiptarëve të Kosovës;
5. Rolin e diasporës shqiptare të Kosovës për vënien e kontakteve të komunikimit

7. Prezantimin e vazhdueshëm të arritjeve shkencore e kulturore kombëtare në vendet ku vepron diaspora jonë (nëpërmjet shpërndarjes së botimeve shkencore që trajtojnë dimensione të identitetit tonë kombëtar etj.);
8. Organizimin e aktiviteteve informative e shkencore në qendrat kryesore ku vepron diaspora shqiptare e Kosovës.

**Realizuesit, bashkëpunimi dhe detyrimet e tyre:**

1. Për mbështetjen e duhur financiare dhe logjistike lidhur me realizimin e aktiviteteve studimore për diasporën shqiptare të Kosovës përkujdeset Ministria e Diasporës e RK dhe përfaqësitë diplomatike-konsullore të Kosovës në vendet ku ndodhet diaspora shqiptare e Kosovës.
2. Për aspektin e realizimit profesional të studimeve lidhur me diasporën shqiptare të Kosovës angazhohet Instituti Albanologjik i Prishtinës, i cili mban të drejtën e angazhimit edhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm në projekte të caktuara.
3. Palët do të këshillohen në mënyrë reciproke me qëllim të zbatimit ligjor e pa pengesë të këtij Memorandumi. Shqyrtimi i zbatimit të këtij Memorandumi do të bëhet çdo vit, ose më parë nëse ka kërkesë të njërës nga Palët.
4. Në fillim të çdo viti kalendarik palët do të hartojnë, në pajtim me këtë Memorandum, programin e aktiviteteve që do të zhvillohen me qëllim të zbatimit dhe arritjen e objektivave të këtij Memorandumi.
5. Çdo çështje lidhur me zbatimin e këtij Memorandumi do të vendoset nga Palët në pajtim me parimet e mirëbesimit dhe bashkëpunimit reciprok.
6. Të gjitha vështirësitë që do të rezultojnë lidhur me interpretimin e dispozitave të këtij Memorandumi do të zgjidhen nga palët nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve.

Nënshkruar në Prishtinë më 24/09/2012, në dy kopje në gjuhën shqipe (një për secilën palë), të dy tekstet të barasvlershme.

Ministri i Diasporës

Ibrahim Makolli



Drejtori i Institutit Albanologjik

Prof. dr. Hysen Matoshi

